



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191963

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05313747

KPPP.nr. 1439/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “DLD Group” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810841636 dhe seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, Pejton, nr. 25, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.H., avokat nga Fushë Kosova, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rr. “UÇK”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 619/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 12.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 619/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 619/23, i lejuar me datë 24.08.2023, nga Përmbaruesi Privat Irfan I. Kërçagu, MBETET NË FUQI.
- III. DETYROHET debitori që, në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej EUR 104.00 (njëqind e katër Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 2022/0021, e datës 27.07.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 619/23, të datës 24.08.2023, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 1,000.00, me kamatë prej 8%, nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim e deri në ditën e ekzekutimit të pagesës, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit për përmbartim.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se urdhri për përmbartim është i pa bazuar, si i tillë është i palejuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se i njëjti nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore dhe se provat të cilat i janë bashkangjitur propozimit nuk janë dokumente të besueshme sipas LPP-së. Më tej, ka theksuar se meqenëse kreditori ka dështuar të bashkangjesë provat e nevojshme mbi të cilat e bazon propozimin për përmbartim dhe në këtë rast ka bashkangjitur vetëm faturën në kopje, andaj nuk i plotëson kushtet esenciale që duhet t’i këtë një faturë sipas nenit 22, lidhur me nenin 29 të LPP-së. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të abrogohet.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit është paraqitur në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është pranuar dhe nënshkruar nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi, si dhe të obligohet debitori të paguajë shpenzimet të përgjigjes në prapësim në vlerë prej EUR 104.00, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “Dokumenti i

besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar". Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *"Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit"*.

Gjykata vlerëson se përmbnuesi privat ka lejuar urdhrin përmbnimos mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 2022/0021, e datës 27.07.2022, faturë kjo e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa e njëjta është pranuar nga ana e debitorit, çka vërtetohet nga formulari mbi dorëzimin e faturës i datës 11.10.2022, i lëshuar nga Drejtoria e Financave në kuadër të debitorit, si dhe nënshkrimit të vendosur në faturë.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbnimos, i plotëson kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbnimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbnim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbnimos në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbnimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër përgjigjes në prapësim të ushtruar, në vlerë prej EUR 104.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:191963
Datë: 12.02.2024
Numri i dokumentit: 05313747

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1439/23, datë 12.02.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.